



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 562/12 Prot.

Tiranë, më 13.02 2025

V E N D I M

Nr. 19 dt. 13.02. 2025

**“PËR
MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E
CIKLIT TË PARË BACHELOR NË “FUSHAT E VEPRIMTARISË FIZIKE, TË
SHËNDETIT DHE REKREACIONIT”,
TË OFRUAR NGA FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT”**

Mbështetur në nenin 38, 91 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzimin nr.10 datë 30.03.2020 të MAS “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.11 datë 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së suplementit të diplomës” në nenin 20, 81 të Statutit të UST-së, në nenin 11 të Rregullores së UST-së, shkresës së FVFR me nr. 475 Prot., datë 06.02.2025 “Përcjellje për miratimin e formës së diplomës për të gjitha ciklet e studimit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit”, Vendimin e Rektoratit nr.23, datë 10.02.2025, Senati në mbledhjen e datës 13.02.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e formës dhe përmbajtjes së diplomës për programin e ciklit të parë bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe Rekreacionit”,
2. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore”.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT



"Bachelor"

në "Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit"

I jepet

Z/Znj: _____, lindur në _____, datë: _____, (data muaji viti)
(emri atësia mbiemri) (vendi)

në përfundim të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", me kohë të plotë, 180 kredite (ECTS), niveli i 6-të, referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Përfundoi studimet në datë: _____, Nr. i matricullimit të studentit; _____
ID e maturës shtetërore/Nr. i regjistrimit të veçantë; _____, Nr. i diplomës _____
Nr. unik i identifikimit; EF8136211347 Data e lëshimit të diplomës; _____

DEKANI

REKTORI

"Kjo diplomë shoqërohet nga suplementi i saj"